

VENDIM
Nr.681, datë 21.5.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRASFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA GOSTIMË TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Gostimë të qarkut të Elbasanit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 7 (shtatë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Gostimë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTËSHME SHTETËRORE

(Sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU										
Komuna: Gostimë										
Nr.	Nr. i pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullimore (EPK) shtrirja gjeografike EPK	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërteses popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sip. në ha	Funksioni për të cilën përdoret prona	Institucioni më përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	956	EP Gostimë - Koprrik	Kodra Bujares	1/a	Tokë me bim.pyjore	10.65		MMPAU	DSHP Elbasan	
2	957	EP Gostimë - Koprrik	Kodra Bujares	1/b	Tokë me bim.pyjore	30.00		MMPAU	DSHP Elbasan	
3	958	EP Gostimë - Koprrik	Hija e Tollumit	2/a	Pyll	41.00	Prodhues	MMPAU	DSHP Elbasan	
4	959	EP Gostimë - Koprrik	Qarrisht	3/a	Pyll	8.00	Prodhues	MMPAU	DSHP Elbasan	
5	960	EP Gostimë - Koprrik	Xik zonja	4/a	Pyll	50.50	Prodhues	MMPAU	DSHP Elbasan	
6	961	EP Gostimë - Koprrik	Guri i Bardhë	5/a	Pyll	8.20	Prodhues	MMPAU	DSHP Elbasan	
7	962	EP Gostimë - Koprrik	Guri i Bardhë	5/b	Inproduktive	6.00		MMPAU	DSHP Elbasan	

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
956 - 962	Pyje, kullota, të tjera	Në pronësi